



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren  
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti i Prizrenit "UKSHIN HOTI"	
Pranuar rre dt.	06.03.2022
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-90

## KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Prizren, më 28.02.2022

Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 3, nenit 22 paragrafi 1 pika 1.6 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621, datë 30 maj 2013, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit në mbledhjen elektronike të mbajtur më 14.02.2022, mori këtë:

### V E N D I M

1. Obligohet Menaxhmenti i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, që mbrenda një afati të arsyeshëm kohor të rishikoj të gjitha vendimet e punës dhe të identifikoj nevojat reale për personel akademik dhe administrativ të Universitetit, për vitin 2022.
2. Në të gjitha njësitë akademike të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, të rishikohet fondi i orëve/ normave dhe çdo angazhim tjetër i personelit akademik.
3. Pa aprovimin paraprak të Këshillit Drejtues të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, asnjë pozitë, funksion apo konkurs publik nuk mund të shpallet në media elektronike, të shkruara apo në ueb faqen e Universitetit.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, në zbatim të nenit 17 paragrafi 3, nenit 22 paragrafi 1 pika 1.6 të Statutit të Universitetit, ka përgjegjësi të përgjithshme strategjike për funksionimin efektiv dhe institucional të Universitetit. Në mënyrë që të siguroj kushte të përshtatshme për veprimtarin e qëndrueshme të Universitetit, sigurimi i resurseve dhe burimeve të nevojshme duhet të mbështet në planifikimin me kohë të kërkesave të Universitetit apo njësive akademike, përkatësisht organeve tjera të Universitetit. Për të rritur transparencën e shpenzimit të parashë publikë, në përputhje me kërkesat statutare dhe kornizën ligjore përkatëse, buxheti i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, duhet të sigurohet me kohë, sipas nevojave reale të Universitetit. Duke marrë parasysh respektimin e kërkesave ligjore si dhe kordinimin me institucionet tjera relevante për mbështetjen dhe, rrjedhën dhe gjetjen e mëmyrës së financimit, Këshilli Drejtues e konsideroi të arsyeshme marrjen e veprimeve konkrete, andaj nga ajo që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Dekanëve të Njësive Akemike;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zyrës Ligjore;
- Shërbimit Financiar të Universitetit;
- Arkivit.

Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Kryesues i Këshillit Drejtues

